

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Osla by Intermedica”Shpk

Ortakët themelues:

1. **Shoqëria “Intermedica Center”Shpk** krijuar me datë 13/03/2003 numër Nipt K31513084W me adresë kryesore në: Rruga Panorama, pranë Hipotekës, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Thoma Vasili me numër Karte Identiteti J11124074J, banues në Tiranë
2. **Znj Oslunena Dervishi** e bija e Osmanit, lindur ne Lezhë dhe banuese në Tiranë me numër Karte Identiteti I959050850.

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 25.06.2022 harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

- 1.1 Shoqëria tregtare mban emrin **“Osla by Intermedica”shpk**.
- 1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 2

Forma

- 2.1 Shoqëria tregtare **“Osla by Intermedica” shpk**,ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3


Zyra Qendrore

- 3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“Osla by Intermedica” shpk** do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën: Kavaje, Lagjia nr 5, Rruga Panairi përballë Ish-Markatës.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

- 4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare në fushën e shërbime analizave mikrobiologjike, kimike,hormonale,bakterologjike,molekulare dhe gjenetike.



Ushtrimi aktiviteti diagnostikues dhe kurues, kurimi semundjeve në kushte ambulatorie, organizim të shërbimit të urgjencës, imazheri dhe konsulta të ndryshme mjekësore

NENI 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “*Osla by Intermedica*” Shpk do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare “*Osla by Intermedica*” Shpk mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortakët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë “*Osla by Intermedica*” Shpk dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “*Osla by Intermedica*” Shpk është 20 000 (një mijë) lekë.

Ortakët e shoqërisë janë:

1- “Intermedica Center” shpk me Nipt K31513084W është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 49 % të kapitalit të shoqërisë.

8.2 Znj Oslunena Dervishi është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 51 % të kapitalit të shoqërisë.


NENI 9

Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.



NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakë e Shoqërisë. Afati i emërimit është 3(tre)vjet. Kompetencat e adminsitrorit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është znj Oslunena Dervishi e bija e Osmanit,e datëlindjes 05/09/1989, lindur në Lezhë dhe banues në Tiranë , madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me numër I959050850.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKËT

E SHOQERISË ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR

Shoqëria “ **Intermedica Center**” sh.p.k..

“*Osla by Intermedica*” Shpk

Perfaqesuar nga administratori

Thoma Vasili

Thoma Vasili



Oslunena Dervishi

[Signature]